



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1189/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Vahit Karavidaj, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Prizren, paraqitur kundër Qendrës të Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Vahit Karavidaj kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prizren, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:03 nga Vahit Karavidaj ku ka pretenduar se pas publikimit të rezultateve përfundimtare të QNR-së, nuk më janë përfshirë të gjitha votat. Bazuar nga dëshmitë që kam nga KKZ-ja në Prizren, konstatoj se me janë hequr votat nga këto qendra nr: 2001a(02r), janë evidentuar 02 vota - mungojnë 14 vota, nr:2001a(05r), janë evidentuar 01 vota - mungojnë 9 vota, nr:2015a(03r) janë evidentuar 05 vota – mungojnë 10 vota, nr: 2005a(10d) janë evidentuar 0 vota – mungojnë 2 vota, nr:2063a(901d) janë evidentuar 0 vota - mungojnë 3 vota, nr:2002a, mungon raporti në vendvotim 08r, nr:2032a nuk ka raport të, kontrollohet raporti ne KQZ. Në këtë kontest jam dëmtuar duke mos më renditur vetëm për disa vota si kandidat fitues për asamble komunale nga radha e LDK-së në Prizren, thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal Vahit Karavidaj janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur dëshmi bindëse, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1189/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.